



European  
Union  
Kosovo



LABYRINTH

qendra për këshillim dhe trajtim të varësisë



# **RAST STUDIMOR PËR** **PËRMIRËSIMIN E TË** **DREJTAVE TË NJERIUT** **TË PËRDORUESVE TË** **DROGAVE NË KOSOVË**

**Rast Studimor për Përmirësimin e të  
Drejtave të Njeriut të Përdoruesve të  
Drogave në Kosovë - ENDURE**

**Autore**

**Avokate Rina Kika LLM**

**Kontribues:**

**Zana Cena**

**Orbis Rexha**

**Lindor Bexheti**

**Muharrem Ademi**

**Publikuar nga**

**Qendra Mediko-Psikoterapike Laby-  
rinth**

**Data e publikimit**

**Prill, 2019**



**LABYRINTH**  
qendra për këshillim dhe trajtim të varësisë

# PËRMBAJTJA

---

|                                                                                     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje.....                                                                          | 4  |
| Metodologjia .....                                                                  | 6  |
| Statistika të përgjithshme.....                                                     | 9  |
| Tregimi i Rastit .....                                                              | 12 |
| Standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.....                     | 16 |
| I. E drejta në liri dhe siguri.....                                                 | 18 |
| II. Ndalimi i torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues..... | 20 |
| i. Marrja në pyetje e të pandehurve.....                                            | 20 |
| ii. Trajtimi mjekësor gjatë mbajtjes, paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit.....     | 21 |
| III. E drejta në jetë private .....                                                 | 23 |
| IV. E drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi.....                               | 28 |
| Përfundime dhe Rekomandime.....                                                     | 36 |
| Referencat.....                                                                     | 39 |

**HYRJE**

---

## HYRJE

---

Ky rast studimor është zhvilluar në kuadër të Programit “ENDURE” – Mbrojtja dhe Fuqizimi i të Drejtave të Përdoruesve të Drogave në Kosovë që udhëhiqet nga Qendra Mediko-Psikoterapike “Labyrinth” dhe ka për qëllim të ofrojë një vështrim të përgjithshëm dhe analizë të qasjes institucionale ndaj përdoruesve të drogave në Kosovë sa i përket respektimit dhe përmbushjes së të drejtave fundamentale njerëzore.

Synimi i këtij dokumenti është t’i shërbejë autoriteteve shtetërore dhe akterëve të tjerë si organizatave të shoqërisë civile dhe vetë përdoruesve të drogave, si hartë për identifikimin e ngecjeve në ofrimin e mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të njeriut për përdoruesit e drogave. Për më tepër, ky dokument ilustron se si stigmatizimi, diskriminimi dhe ndëshkimi nga autoritetet ndikon në cilësinë e jetës së përdoruesve të drogave. Ndër të tjera ky dokument mund t’i hyjë në punë autoriteteve publike për identifikimin e prioritetëve në nivel nacional dhe për planifikimin strategjik të adresimit të problemit të drogave në Kosovë.

Analiza përqendrohet në tregimin personal të një përdoruesi të drogave nga Prishtina i cili ka pasur përvoja të ndryshme me autoritet publike në Kosovë duke përfshirë Policinë e Kosovës, qendrat e paraburgimit dhe qendrat korrektuese, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Institucionin e Avokatit të Popullit. Identifikimi dhe analizimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut tregohet përmes rrugëtimit të tij dhe kontaktit të tij me autoritetet publike. Në fund të këtij dokumenti janë paraqitur disa rekomandime në lidhje me atë se si mund të përmirësohet situata e të drejtave të njeriut për përdoruesit e drogave në Kosovë.

# **METODOLOGJIA**

---

## METODOLOGJIA

Të dhënat dhe informatat e paraqitura në këtë dokument bazohen në katër intervista të realizuara në shkurt 2019 me përdorues të drogave (3 meshkuj dhe 1 femër), një numër të madh të informatave të siguruara nga kërkesat për qasje në dokumente publike si dhe nga raporte e informata tjera të qasshme publikisht.

Të gjithë të intervistuarit janë të regjistruar në Programin e Trajtimit me Metadon në Qendrën Mediko-Psikoterapike "Labyrinth". Për ilustrimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut, është zgjedhur intervista me më së shumti pretendime për shkelje të të drejtave të njeriut. Të gjitha intervistat janë zhvilluar individualisht në zyret e Qendrës Mediko-Psikoterapike "Labyrinth" në Prishtinë. Të intervistuarit janë informuar paraprakisht në lidhje me qëllimin e intervistës dhe kanë dhënë pëlqimin për përdorimin dhe përfshirjen e informatave nga intervistat në këtë dokument. Me qëllim të ruajtjes së privatësisë dhe sigurisë së personit të intervistuar, pretendimet e të cilit janë shtjelluar hollësisht në këtë dokument, kemi ndryshuar një numër të madh të të dhënave që do ta bënin të identifikueshëm.

Personi i intervistuar asnjëherë nuk ka paraqitur ankesë formale për trajtimin që i është bërë nga autoritetet publike, andaj ky dokument nuk ka për synim t'i paraqesë pretendimet e parashtruara si fakte të vërtetuara. Pretendimet e personit të intervistuar që janë konfirmuar me anë të informatave të siguruara nga kërkesat për qasje në informata apo kërkesat për qasje në dokumente publike, përmenden shprehimisht në tekstin e mëposhtëm. Për qëllim të ilustrimit të situatave, veprimeve e fenomeneve që mund të paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut të përdoruesve të drogave, ky dokument është përpiluar nën supozimin se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur.

Gjatë hulumtimit, i jemi drejtuar një numri të madh të institucioneve publike dhe akterëve të ndryshëm me kërkesa për informata dhe kërkesa për qasje në dokumente publike, përfshirë këtu: Ministrinë e Shëndetësisë – Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, Institucionin e Avokatit të Popullit, Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës ("MKPT"), Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë, Avokatin e caktuar sipas detyrës zyrtare për mbrojtjen personit të intervistuar, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Klinikën e Psikiatrisë – Repartin për Sëmundjet e

Varësisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (“QKUK”), Qendrën e Emergjencës së QKUK dhe OJQ Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës (“QKRMT”).

Duke vepruar sipas kërkesës së personit të intervistuar, nuk e kemi kontaktuar stacionin policor, qendrën korrektuese dhe qendrën e paraburgimit ku është mbajtur personi i intervistuar. Informatat e siguruara nga përgjigjet në kërkesat për qasje në dokumente publike janë të paraqitura në nën-ndarjet e mëposhtme.

Nga Ministria e Shëndetësisë, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve kemi kërkuar që sipas autorizimit nga pala të na sigurohen të gjitha raportet dhe dosjet mjekësore të personit të intervistuar. Na është siguruar vetëm një raport në lidhje me shërbimet mjekësore të ofruara gjatë qëndrimit për një periudhë të shkurtër të personit të intervistuar në njërën nga qendrat korrektuese në Kosovë.



# STATISTIKA TË

---

# PËRGJITHSHME

---

## STATISTIKA TË PËRGJITHSHME

Në vazhdim janë paraqitur të dhëna statistikore në lidhje me numrine përgjithshëm të përdoruesve të drogave të regjistruar për trajtim mjekësor në QKUK, numrit të përgjithshëm të personave që janë në vuajtje të dënimit për kryerjen e veprave penale që kanë të bëjnë me substanca narkotike, si dhe numrin e përgjithshëm të përdoruesve të drogave të regjistruar për trajtim me metadon në Qendrën Mediko-Psikoterapike “Labyrinth”.

Sipas të dhënave të siguruara në muajin prill 2019, në Klinikën e Psikiatrisë, Reparti për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë në QKUK, janë të shtrirë 6 pacientë që janë përdorues të drogave (3 femra dhe 3 meshkuj).<sup>1</sup> Njëri nga ta i takon përkatësisë rome, ndërkaq të tjerët janë shqiptarë.<sup>2</sup> Krahas kësaj, trajtim të vazhdueshëm me metadon,

në QKUK marrin gjithsej 18 persona nga ta 16 janë meshkuj dhe 2 janë femra.<sup>3</sup>

Sa i përket numrit të përgjithshëm të personave të burgosur, sipas të dhënave në muajin prill 2019 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, në Qendrën Korrektuese në Lipjan, nga 62 të burgosur, 7 nga ta janë të dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me narkotikë. Në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë janë gjithsej 119 të burgosur, mirëpo nuk ka të dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me narkotikë. Në Qendrën Korrektuese në Dubravë nga 813 të burgosur, 113 të burgosur janë të dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me narkotikë, pra 14 %.<sup>4</sup> Nga numri i përgjithshëm i të burgosur në këtë qendër korrektuese, 9 gjenden në fundjavë ndërsa 3 gjenden në spital.

Nga të dhënat e Raportit Statistikor 2019 të Qendrës Mediko-Psikoterapike “Labyrinth”, pranë kësaj qendre nga viti 2002 deri në vitin 2019 janë regjistruar

<sup>1</sup> KLINIKA E PSIKIATRISË QKUK, DR. SAMIRE BRAINA, UD SHEF I REPARTIT PËR TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE TË VARËSISË, PËRGJIGJE NË KËRKESËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË DATËS 04 PRILL 2019, DËRGUAR PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE MË DATË 10 PRILL 2019.

<sup>2</sup> Po ATY.

<sup>3</sup> Po ATY.

<sup>4</sup> 113 PERSONA TË CILËT E VUAJNË DËNIMIN NË QENDRËN KORREKTUESE NË DUBRAVË PËR VEPRAT PENALE QË KANË TË BËJNË ME SUBSTANCA ILEGALE NARKOTIKE NUK JANË DOMOSDOSHMERISHT PËRDORUES TË DROGAVE. INFORMATAT E SIGURUARA NGA SHËRBIIMI KORREKTUES I KOSOVES, I CILI FUNKSIONON NË KUADËR TË MINISTRISË SË DREJTËSISË KA TË BËJË VETËM ME PERSONAT E DËNUAR PËR VEPRAT PENALE QË NDËRLIDHEN ME SUBSTANCA ILEGALE NARKOTIKE.

gjithsej 1262 përdorues të drogave.<sup>5</sup> Nga ta janë 1163 meshkuj ose 92 %, dhe 99 femra ose 7.8 %. Moshë mesatare e personave të regjistruar si përdorues të drogave është 28 vjeç<sup>6</sup> kurse moshë mesatare e personave që kanë provuar për herë të parë drogë është 18 vjeç<sup>7</sup>. Sa i përket shkollimit, 63% kanë kryer shkollën e mesme ndërkah vetëm 33% janë të punësuar.<sup>8</sup> Nga numri i përgjithshëm i përdoruesve të drogave të regjistruar në Labyrinth gjatë këtyre viteve, 25% prej tyre kanë përjetuar mbidozë.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> QENDRA MEDIKO-PSIKOTERAPIKE LABYRINTH, RAPORT STATISTIKOR, 30 JANAR 2019, FAQE 1.

<sup>6</sup> PO ATY.

<sup>7</sup> PO ATY, FAQE 2.

<sup>8</sup> PO ATY, FAQE 3.

<sup>9</sup> PO ATY, FAQE 2.

# TREGIMI I RASTIT

---

## TREGIMI I RASTIT<sup>10</sup>

Jetoni është 30 vjeçar. Ai jeton në Prishtinë, është i papunë dhe është ndarë nga partnerja e tij me të cilën ka bashkëjetuar. Që nga adoleshenca, ka filluar të përdorë drogë dhe pas një kohe ka krijuar varësi nga heroína.

Për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike dhe varësisë së krijuar, Jetoni fillon të shesë drogë dhe arrestohet për herë të parë nga Njësiti Anti-Drogë i Policisë për posedim dhe shitje të substancave narkotike. Sipas deklarimeve të tij, Njësiti Anti-Drogë e dërgon në stacion të policisë dhe ushtron dhunë fizike ndaj tij për rreth katër orë pa ndërprerje, gjithnjë duke kërkuar informata në lidhje me posedimin dhe shitjen e substancave narkotike. Sipas Jetonit, policët gjatë kësaj kohe shkruajnë deklaratë në emër të tij duke futur deklarata të cilat ai asnjëherë nuk i ka bërë. Jetonit i kujtohet të jetë alivanosur dy herë gjatë marrjes në pyetje nga Njësiti Anti-Drogë.

Policët nuk e informojnë Jetonin në lidhje me të drejtën e tij për t'u mbrojtur në heshtje, të drejtën e tij në avokat, të drejtën e tij në ndihmë mjekësore, apo të drejtën e tij për ta kontaktuar familjen apo një person të afërt. E tërë marrja në pyetje kryhet pa praninë e avokatit dhe nën ushtrimin e dhunës fizike. Pas 24 orësh mbajtje në stacionin e Njësitis Anti-Drogë, Jetoni dërgohet në Stacionin Policor Qendra, ku i lexohen të drejtat e tij nga një polic intervistues i cili e thërret Odën e Avokatëve për t'ia caktuar një avokat sipas detyrës zyrtare. Avokati arrin në Stacionin Policor Qendra dhe e përfaqëson Jetonin gjatë intervistimit në këtë stacion. Me urdhër të Prokurorit, Jetoni dërgohet në mbajtje. Ai nuk ndihet i sigurtë t'i tregojë për dhunën e përjetuar Avokatit dhe nuk ndihet i sigurtë të ankohet për trajtimin që i është bërë. Ai nuk është i informuar në lidhje me Inspektoratin Policor dhe konsideron se "Ata [policët e Anti-Drogës dhe të gjithë policët tjerë] janë të gjithë shokë dhe e dijnë se çka ndodhë në stacion policor". Në mungesë të trajtimit mjekësor, në ditën e dytë të qëndrimit në mbajtje për shkak të varësisë nga heroína Jetoni

<sup>10</sup> ME QËLLIM TË RUAJTJES SË PRIVATËSISË SË PERSONIT TË INTERVISTUAR, TË GJITHA INFORMATAT QË DO TA BËNIN TË IDENTIFIKUESHËM PERSONIN JANË FSHIRË APO NDRYSHUAR NGA PËRMBAJTJA E KËTJË TEKSTI. INFORMATAT QË PËRFSHIHEN NË KËTË NËN-NDARJE JANË GJENERUAR NGA INTERVISTA E ZHVILLUAR ME PËRDORUESIN E DROGAVE TË CILIN NË KËTË DOKUMENT E KEMI QUAJTUR JETON. EMRI I TIJ I VËRTETË ËSHTË I NJOHUR PËR QENDRËN MEDIKO-PSIKOTERAPEIKE "LABYRINTH". INFORMATAT E PËRFSHIRA NË KËTË NËN-NDARJE JANË PRETENDIME TË PERSONIT TË INTERVISTUAR DHE DUHET TË LEXOHEIN SI TË TILLA. PRETENDIMET E KONFIRMUARA JANË SHTJELLUAR NË NËN-NDARJET E MËPOSHTME.

fillon të ketë problem me frymëmarrje, të përjetojë sulme të panikës, e fillon të ketë dhimbje të mëdha fizike.

Ai vazhdimisht kërkon ndihmë mjekësore nga policët, të cilët pasi e shohin gjendjen e rëndë shëndetësore të Jetonit e thërrasin Ndihmën e Shpejtë dhe ai dërgohet në Qendrën e Emergjencës, në QKUK. Atje i jepet trajtimi me metadon.

Gjykatësi i procedurës paraprake ia cakton Jetonit masën e paraburgimit dhe ai dërgohet në qendër të paraburgimit. Në shqyrtim kryesor të procesit gjyqësor, Jetoni përfaqësohet nga një avokat dhe i lexohen të drejtat në procedurë. Jetoni shpallet fajtor për veprën penale posedim dhe shitje e narkotikëve dhe i shqiptohet dënimi prej 2 vite burgim efektiv dhe gjobë. Ai dërgohet për mbajtje të dënimit në një qendër korrektuese. Personelit të qendrës korrektuese, Jetoni i tregon se është i varur nga droga dhe se ka nevojë për trajtim mjekësor. Pavarësisht kësaj, Jetonit nuk i ofrohet trajtim mjekësor për 4 ditë dhe si pasojë e kësaj, atij i përkeqësohet gjendja shëndetësore. Një zyrtar korrektues i Qendrës Korrektuese ushtron dhunë fizike mbi të për shkak se ai kërkon vazhdimisht trajtim mjekësor. Pas 4 ditëve i jepet trajtimi me metadon dhe vazhdon t'i

jepet për çdo ditë gjatë tërë qëndrimit të tij në burg. Ai i mban 6 muaj burg në qendërkorrektuese dhe më pas gjykata e liron me kusht.

Jetoni kthehet te familja e tij, i pa punë, nuk sheh perspektivë tjetër dhe fillon sërish të përdorë drogë dhe të shesë sasi të vogla të drogës për ta siguruar jetesën për veten dhe familjen. Ai arresohet sërish nga Njësi Anti-Drogë e Policisë për shitje dhe posedim të substancave narkotike. Jetoni deklaron se dëshiron të mbrohet në heshtje, ndërkaq sërish merret në pyetje pa praninë e avokatit.

Jetoni thotë se njëri nga Policët e Njësisë Anti-Drogë i është drejtuar me këto fjalë: “Shpirtin kom me ta nxjerrë, ku është malli!” Polici në fjalë, sipas Jetonit, deri sa ia ka shtruar pyetjet në lidhje me veprën penale të dyshuar, e nxjerrë revolen dhe ia heqë të gjitha fishekët, pastaj shtie me revole të zbrazët në drejtim të murit në prani të Jetonit. Për shkak të presionit të madh, Jetoni thotë se i ka thënë policit “vramë”.

Nën përcjelljen e policisë, Jetoni thotë se është dërguar në shtëpinë e tij dhe i ka treguar policëve se në cilin vend të shtëpisë i ka fshehur disa gram drogë të llojit heroinë.

Edhe në veturën e policisë, Jetoni thotë se policët e kanë rrahur dhe e kanë kapur disa herë për fyti. Ai dërgohet sërish në mbajtje të burgimit në qendër korrektuese ku sërish trajtimi me metadon i jepet tek pas 4 ditëve që arrin në Qendër. Për çdo ditë, gjatë shëtitjes së të burgosurve, zyrtari korrektues i burgut e thërret Jetonin me zë të lartë në prani të të burgosurve të tjerë duke i thënë gjëra si: “O kubikash<sup>11</sup>, a t’u ka dhezë drita e kuqe? Hajde me pi benzinën! Hajde pije ujin zamzam<sup>12</sup>!”. Më pas, të gjithë të burgosurit e kuptojnë se ai është përdorues i drogës dhe fillojnë ta ngacmojnë e të tallen me të. Si pasojë e kësaj, acarohet raporti me të burgosurit e tjerë dhe ndodhin disa konflikte fizike në mes të Jetonit dhe tyre. Gjatë kohës në burg, Jetoni thotë se i ka dëgjuar disa herë zyrtarët korrektues duke biseduar me të burgosurit e tjerë për varësinë e tij nga droga. Ai thotë se nuk është ndier i sigurtë të paraqesë ankesë nga frika se do t’i hakmerren zyrtarët korrektues.

Jetoni i drejtohet QKUK-së dhe kërkon të shtrohet për trajtim në Klinikën e

Psikiatrisë në Repartin për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë.

Ky Repart refuzon ta pranojë në Klinikë për shkak se Jetoni nuk arrin të sjellë me vete një person të afërm apo të familjes që ta shoqërojë në Klinikë gjatë procesit të regjistrimit. Jetoni vazhdon trajtimin me metadon, një natë merr dozë të lartë të metadonit dhe si pasojë e kësaj i përkeqësohet shumë gjendja shëndetësore. Ai arrin në Qendrën e Emergjencës në QKUK dhe kërkon ndihmë mjekësore. Personeli shëndetësor i Qendrës Emergjente nuk i jep trajtim shëndetësor, ndërkaq njëri nga ta i thotë: “Pije pak ujë, flladitu. S’kena çka me t’ba na ty”. Jetoni vazhdon të marrë trajtimin me metadon nga Qendra Mediko-Psikoterapike Labyrinth dhe thotë se kurrë më nuk do t’i drejtohet QKUK-së për ndihmë.

<sup>11</sup> “Kubikash” – zhargon, emër përçmues për ta përshkruar një person që është i varur nga droga, sinonim me fjalën “drogirash”.

<sup>12</sup> “Uji zamzam”, ose “uji zemzem” i referohet ujit të burimit në Qabe (vend i rëndësishëm i ritualeve të fesë Islame) në Mekë të Arabisë Saudite. <https://www.aa.com.tr/en/culture-and-art/saudi-arabia-com-pletet-renovation-of-zamzam-well/1101268>; Sipas faqes së anketës gjeologjike të Arabisë Saudite, i referohet ujit të burimit brenda xhamisë së shenjtë të Mekës, <https://www.sgs.org.sa/english/earth/pages/zamzam.aspx>.

**STANDARDET E**  
**MBROJTJES SË**  
**TË DREJTAVE TË**  
**NJERIUT NË**  
**KOSOVË**



# STANDARDET E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut ("Deklarata Universale"), Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj ("KEDNJ"), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj ("Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike") apo e Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese ("Konventa kundër Torturës"). Sidoqoftë, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të gjitha këto konventa janë të aplikueshme drejtëpërdrejtë në Kosovë, dhe për më tepër mbizotërojnë, në rast të mos-përputhjes, ndaj dispozitave ligjore dhe akteve tjera të institucioneve publike në Kosovë. Përveç kësaj, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore në Republikën e Kosovës interpretohen në harmoni

me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ").

Dispozitat e konventave të përmendura më lartë dhe një numër i madh i standardeve të vendosura nga GJEDNJ janë të përfshira në legjislacionin pozitiv të Kosovës dhe do të shtjellohen në kontekstin e rastit të ilustruar në këtë dokument. Disa nga standardet kryesore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë të cilat janë të rëndësishme për këtë rast studimor janë të paraqitura në vijim.

## Kushtetuta e Kosovës

### Neni 24, Barazia para Ligjit

"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."

### Neni 27, Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar

"Askush nuk i nënshtrohet torturës,

ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues.”

### **Neni 29, E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë**

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim. (...)

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë

të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

### **Neni 30, Të Drejtat e të Akuzuarit**

“Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit; (...)
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojt

jen e vet;

(4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; (...)

(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.”

### **Neni 36, E Drejta e Privatësisë**

“1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera. (...)

4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.”

## **I. E DREJTA NË LIRI**

---

### **DHE SIGURI**

---

Gjatë 24 orëve të para të kaluara në Stacionin e Njesisë Anti-Drogë, Jetoni thotë se asnjëherë nuk është informuar në lidhje me të drejtën për t’u mbojtur në heshtje, të drejtën për të mos e inkriminuar veten, të drejtën në avokat,

të drejtën në ndihmë mjekësore, apo të drejtën e tij për ta kontaktuar familjen apo një person të afërm.

### **Çfarë obligimesh për informim kanë zyrtarët policor ndaj të pandehurve gjatë marrjes në pyetje?**

Secilit person i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë.<sup>13</sup> Në kuadër të kësaj të drejte shteti duhet të përmbushë obligimet pozitive për sigurimin dhe garantimin e saj, ndër të tjera ka për obligim të sigurojë që çdokush që privohet nga liria të informohet se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë, se ka të drejtë të ketë një mbrojtës (avokat) sipas zgjedhjes së tij, se ka të drejtë të përdorë mjete juridike për ta sfiduar ligjshmërinë e arrestimit apo ndalimit dhe se ka të drejtë ta informojë për arrestimin personin sipas zgjedhjes së vet.<sup>14</sup>

Të drejtat e njeriut që i garantohen personit të arrestuar janë të përfshira edhe në Kodin Nr. 04/L-123 të Proedurës Penale të Republikës së Kosovës (“KPPK”). Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia ka të drejtë që pa urdhër të

---

<sup>13</sup> Neni 29, paragrafi 1, Kushtetuta Republikës së Kosovës.

<sup>14</sup> Neni 29, paragrafi 3 dhe 4, Kushtetuta Republikës së Kosovës

gjykatës ta arrestojë personin.<sup>15</sup> Sidoqoftë, gjatë arrestimit dhe gjatë ndalimit policor, policia është e obliguar t'i respektojë të drejtat e personit të arrestuar dhe duhet t'i përmbahet kufizimeve të parapara me ligj.<sup>16</sup>

Gjatë marrjes në pyetje nga policia, personin e arrestuar duhet ta informojë në lidhje me të drejtat si vijon:

- 1) Të drejtën të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij;
- 2) Të drejtën t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit;
- 3) Të drejtën ta shfrytëzojë ndihmën e avokatit dhe t'i caktohet një avokat nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;
- 4) Të drejtën që për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij; dhe

5) Të drejtën në kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.<sup>17</sup>

Çdo deklaratë e marrë në kundërshtim me këto rregulla është e papranueshme si provë në gjykatë.<sup>18</sup> Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në prova të papranueshme.<sup>19</sup> Sipas Jetonit, herën e parë që është arrestuar gjatë 24 orëve sa ka zgjatur ndalimi policor, policia nuk ia ka komunikuar asnjëherë të drejtat e tij. Jetoni pretendon se nuk është informuar se ka të drejtë të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij, se ka të drejtë të shfrytëzojë ndihmën e avokatit, se ka të drejtë ta lajmërojë ndonjë person të afërm në lidhje me arrestimin dhe se ka të drejtë të ketë trajtim mjekësor, e madje edhe në trajtim psikiatrik. Prandaj mund të thuhet se në rastin e Jetonit kemi të bëjmë me shkeljen e të drejtës në liri dhe siguri e garantuar me nenin 29 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 5 KEDNJ.

<sup>15</sup> NENI 162 KPPK.

<sup>16</sup> NENI 164, PARAGRAFI 3 KPPK.

<sup>17</sup> NENI 164, PARAGRAFI 3, 4 DHE NENI 167 KPPK.

<sup>18</sup> NENI 155 KPPK.

<sup>19</sup> NENI 257, PARAGRAFI 3 KPPK.

## II. NDALIMI I TORTURËS, NDËSHKIMIT A TRAJTIMIT MIZOR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

Jetoni thotë se është rrahur nga Policia e Njesisë Anti-Drogë për katër orë dhe gjatë kësaj kohe është marrë në pyetje në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale posedim dhe shitje të substancave narkotike. ,

### I. MARRJA NË PYETJE E TË PANDEHURVE

**Çfarë obligimesh kanë zyrtarët policorë ndaj personave në mbajtje që akuzohen për kryerjen e një veprë penale?**

Tortura, ndëshkimi a trajtimi mizor, çnjërëzor ose poshtërues është i ndalu- ar.<sup>20</sup> Liria nga tortura është vlerësuar nga GJEDNJ si një ndër vlerat funda- mentale të një shoqërie demokratike.<sup>21</sup> “Edhe në rrethanat më të vështira, si në raste të luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit, KEDNJ e ndalon abso-

përdorimin e torturës, ndëshkimit a trajtimit çnjërëzor ose poshtërues.”<sup>22</sup> Përkundër shumicës së të drejtave të garantuara në Konventë të cilat mund të kufizohen në rrethana të caktuara, liria nga tortura është e drejtë absolute dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë përjash- tim a mundësi derogimi për shtetet nënshkruese të saj.<sup>23</sup> As edhe në raste të emergjencës publike që paraqet rrezik për popullatën e përgjithshme nuk lejohet të shkelet e drejta për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjërëzor ose poshtërues.<sup>24</sup>

Kodi i Procedurës Penale përcakton kufizime shtesë për procesin e marrjes në pyetje të të pandehurve, konkretisht përcakton se gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje është e ndaluar që:

“4.1. liria e të pandehurit për të formu- luar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit; (...)”<sup>25</sup>

Intervistimi dhe marrja në pyetje e cila bëhet në kundërshtim me këto rregulla

<sup>20</sup> Neni 27 Kushtetuta e Kosovës, Neni 3 KEDNJ.

<sup>21</sup> Aksoy kundër Turqisë, GJEDNJ, Nr.21987/93, 1993, paragrafi 62 dhe referncat në të.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Neni 257, paragrafi 4 KPPK.

nuk mund të përdoret në proces gjyqësor sepse procesverbali i marrjes në pyetje është i papranueshëm.<sup>26</sup> Jetoni pretendon se Njësiti Anti-Drogë e Policisë, e ka keqtrajtuar gjatë marrjes në pyetje, ka ushtruar dhunë fizike mbi të dhe përmes shtrëngimit i ka marrë deklaratat nga ai. Të gjitha deklaratat e dhëna nga Jetoni para policisë do të ishin trajtuar si të papranueshme nga gjykata në qoftë se do të ishte konstatuar se ka pasur keqtrajtim dhe dhunë fizike gjatë intervistimit të Jetonit. Sidoqoftë, Jetoni nuk ka paraqitur asnjëherë ankesë para asnjë instance në lidhje me trajtimin e tij gjatë marrjes në pyetje në stacionin e policisë së Njesisë Anti-Drogë, andaj të gjitha deklaratat e dhëna janë trajtuar si dëshmi të pranueshme në proces gjyqësor dhe janë marrë parasysh për nxjerrjen e vendimit përfundimtar për çështjen e tij penale.

## II. TRAJTIMI MJEKËSOR GJATË MBAJTJES, PARABURGIMIT DHE VUAJTJES SË DËNIMIT

Jetoni ka deklaruar se gjatë qëndrimit në mbajtje në stacionin e policisë nuk i

është ofruar trajtim mjekësor për 48 orë, si pasojë e kësaj i është përkeqësuar shumë gjendja shëndetësore dhe policia ka thirrur Shërbimin Emergjent të QKUK-së. Më tej, Jetoni ka deklaruar se kur është dërguar në mbajtje të dënimit në qendrën korrektuese, trajtimi me metadon i është dhënë 4 ditë pasi ka arritur në këtë qendër

### **Çfarë obligimesh kanë zyrtarët policor ndaj personave që i kanë në mbajtje të cilët kanë nevojë për trajtim mjekësor?**

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve i Ministrisë së Shëndetësisë ka konfirmuar se Jetonit i është dhënë trajtimi me metadon në qendër korrektuese 4 ditë pasi ka arritur në qendër.<sup>27</sup>

E drejta në trajtim mjekësor e edhe në trajtim psikologjik është e drejtë e garantuar për çdo person të pandehur për kryerjen e një vepre penale.<sup>28</sup> Policia e ka për obligim që ta njoftojë personin që e interviston se ka të drejtë në trajtim mjekësor.<sup>29</sup> Në rastin Wenner kundër Gjermanisë, GJEDNJ ka theksuar se neni 3 i Konventës që e parasheh lirinë nga tortura, i obligon shtetet të ndërmarin veprime për t'u siguruar që personave

<sup>26</sup> Neni 257, paragrafi 6 KPPK.

<sup>27</sup> Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë, Përgjigje në Kërkesën për qasje në informata të datës 20 shkurt 2019, dërguar më datë 1 mars 2019.

<sup>28</sup> Neni 167, paragrafi 1, pika 6 KPPK.

<sup>29</sup> Po aty.

të privuar nga liria mbahen në kushte që janë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor, që mënyrat dhe metodat e ekzekutimit të masës së heqjes së lirisë të mos e vendosin individin në ankth apo në shqetësim që e tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes nga vetë heqja e lirisë dhe po ashtu i obligon shtetet të ofrojnë asistencë dhe trajtim mjekësor për personat e privuar nga liria në mënyrë që të sigurohet shëndeti dhe mirëqenia e tyre.<sup>30</sup> Sipas GJEDNJ, të burgosurit kanë të drejtë në trajtim të ngjajshëm mjekësor me trajtimin mjekësor që është i qasshëm për pacientët që gjenden në liri, dhe duhet të kenë qasje në shërbime shëndetësore që janë të qasshme në atë shtet pa diskriminim në bazë të statusit të tyre ligjor.<sup>31</sup> Në rastin Wenner kundër Gjermanisë GJEDNJ ka gjetur se ka pasur shkelje të të drejtës së Z. Wenner për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor e mizor, për shkak se autoritetet e burgut nuk i kishin ofruar trajtim me metadon, pavarësisht faktit se para se të burgosej ankuesi kishte marrë rekomandim të mjekut për trajtim mjekësor me metadon<sup>32</sup>.

Sipas GJEDNJ, autoritetet e burgjeve duhet t'i ofrojnë të burgosurit trajtim të përshtatshëm me sëmundjen me të cilën është diagnostifikuar i burgosuri nga mjekët kompetent.<sup>33</sup>

Pretendimet e Jetonit janë të përafërta me pretendimet e Z. Wenner në rastin Wenner kundër Gjermanisë, sepse edhe Jetoni është përdorues i drogave për shumë vite dhe para se të burgosej ishte regjistruar në programin e trajtimit me metadon, pas realizimit të kontrollit mjekësor. Në një rast ku personi i arrestuar pretendon se as që është informuar se ka të drejtë në trajtim mjekësor, dhe për më tepër, pretendon se nuk i është dhënë trajtimi mjekësor pavarësisht faktit se e ka kërkuar atë për shkak të përkeqësimit të gjendjes mjekësore, mund të konsiderohet se shteti ka dështuar t'i ofrojë kushtet gjatë heqjes së lirisë të cilat do të ishin në përputhje me obligimin për të siguruar që personi nuk i nënshtrohet trajtimit që nuk përputhet me lirinë nga tortura, trajtimi çnjerëzor e poshtërues.

Raportuesi Special për Torturë dhe Trajtim Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues i emëruar nga Komisioneri i

---

<sup>30</sup> Wenner kundër Gjermanisë, GJEDNJ, Nr.62303/13, 1 shtator 2016, paragrafi 55 dhe referencat në të.

<sup>31</sup> Po aty, paragrafi 66 dhe referencat në të.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Po aty, paragrafi 57 dhe referencat në të.



Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka identifikuar praktika të ngjashme në disa shtete, ku agjencitë shtetërore qëllimisht ia kanë mohuar terapinë zëvendësuese me opioid (trajtimin me metadon) personave të arrestuar që vuajnë nga varësia e drogave, me qëllim të nxjerrjes së rrëfimit për krimet e kryera ose me qëllim të marrjes së informatave nga personat në mbajtje.<sup>34</sup> Këto praktika Raportuesi Special për Torturë i ka cilësuar si torturë ose trajtim poshtëruar, madje në rrethana të caktuara i ka cilësuar si të tilla edhe nëse kjo praktikë është zbatuar pa qëllim të marrjes së informatave.<sup>35</sup>

### III. E DREJTA NË JETË PRIVATE

Jetoni dërgohet sërish në mbajtje të burgimit në qendër korrektuese ku ai thotë se sërish nuk i është ofruar trajtimi me metadon deri 4 ditë pas arritjes në qendër. Për çdo ditë, në kohën e marrjes së trajtimit me

metadon, gjatë shëtitjes së të burgosurve, zyrtari korrektues i burgut e thërret Jetonin me zë të lartë para të gjithë të burgosurve të tjerë me fjalë si: “O kubikash, a t’u ka dhezë drita e kuqe? Hajde pije ujin zam-zam!”<sup>36</sup> Kështu të gjithë të burgosurit e kuptojnë se ai është përdorues i drogës dhe fillojnë ta ngacmojnë e të tallen me të. Si pasojë, acarohet raporti me të burgosurit e tjerë dhe ndodhin disa konflikte fizike në mes të Jetonit dhe të burgosurve të tjerë. Gjatë kohës në burg, Jetoni thotë se i ka dëgjuar disa herë zyrtarët korrektues të burgut duke biseduar me të burgosurit e tjerë për varësinë e tij nga droga.

#### Çfarë obligimesh kanë zyrtarët korrektues të burgut kundrejt të burgosurve?

Gjatë mbajtjes së paraburgimit, personaliteti dhe dinjiteti i të paraburgosurit nuk duhet të fyhet.<sup>37</sup> Përveç kësaj, i paraburgosuri duhet të trajtohet në mënyrë humane dhe duhet ndërmarrë veprime për mbrojtjen e shëndetit të tij fizik dhe psikik.<sup>38</sup>

<sup>34</sup> Kombet e Bashkuara, Raporti i Raportuesit Special për Torturë dhe Trajtim Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar, Juan E. Méndez, 1 shkurt 2013, faqe 17, paragrafi 73.

<sup>35</sup> Këshillpërtëdrejtat e Njeriut, Studim mbi ndikimin e problemit botëror të drogave në të drejtat e njeriut – Raport i Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 4 shtator 2015, faqe 9, paragrafi 37.

<sup>36</sup> “Uji zamzam”, ose “uji zemzem” i referohet ujit të burimit në Qabe (vend i rëndësishëm i ritualeve të fesë Islame) në Mekë të Arabisë Saudite. <https://www.aa.com.tr/en/culture-and-art/saudi-arabia-com-pletes-renovation-of-zamzam-well/1101268>; Sipas faqes së anketës gjeologjike të Arabisë Saudite, i referohet ujit të burimit brenda xhamisë së shenjtë të Mekës, <https://www.sgs.org.sa/english/earth/pages/zamzam.aspx>.

<sup>37</sup> NENI 194 KPPK.

<sup>38</sup> PO ATY.



Kodi i Procedurës Penale lejon kufizimet që janë të nevojshme për të penguar ikjen ose komunikimet që do të ishin të dëmshme për zbatimin efektiv të procedurës penale.<sup>39</sup> Në rrethanat e pohuara nga Jetoni, nuk janë plotësuar kushtet për tu zbatuar një përjashtim nga rregulli i trajtimit të personave të paraburgosur pa i fyer, me dinjitet dhe në mënyrë humane sipas Kodit të Procedurës Penale. Adresimi i Jetonit nga zyrtarët korrektues me fjalë si “O kubikash, a t’u ka dhezë drita e kuqe? Hajde me pi benzinën! Hajde pije ujin zam-zam!”, qoftë para të burgosurve të tjerë apo edhe pa praninë e të tjerëve, mund të konsiderohet fyes sepse zyrtarët korrektues në këtë kontekst janë në pozitë autoritative dhe mund të thuhet se ju kanë drejtuar Jetonit me fjalë përçmuese që burojnë nga paragjykimi dhe stigmatizimi i përdoruesve të drogave.

Sidoqoftë, ky nuk është problemi i vetëm në rastin e spjeguar nga Jetoni sa i përket aspektit të të drejtave të njeriut. Zbulimi i informatës se Jetoni merr trajtim me metadon për shkak se ka varësi nga heroina para të burgosurve të tjerë pa pëlqimin paraprak të Jetonit

është çështje që duhet shqyrtuar me kujdes.

Kushtetuta e Kosovës e garanton të drejtën në privatësi për të gjithë dhe përcakton se “Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.”<sup>40</sup> Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pjesë e të dhënave të ndjeshme personale është edhe çdo e dhënë që ka të bëjë me gjendjen shëndetësore të personit.<sup>41</sup> Prandaj informata se një person është përdorues i drogave dhe i nënshtrohet trajtimit me metadon në burg hyn në kuadër të të dhënave personale të mbrojtura. Por, a kanë pasur të drejtë apo kur kanë të drejtë zyrtarët korrektues të burgut të shpërndajnë apo zbulojnë të dhëna të tilla për të burgosurit ndaj të burgosurve tjerë?

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton si “përpunim” të të dhënave personale çdo veprim ose një sërë veprimesh që kryhen në të dhënat personale duke përfshirë ndër të tjera ruajtjen, organizimin, përdorimin, publikimin nëpërmjet transmetimit, shpërndarjes ose ofrimit të të dhënave personale<sup>42</sup>

<sup>39</sup> PO ATY.

<sup>40</sup> NENI 36, PARAGRAFI 4 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

<sup>41</sup> NENI 3, PARAGRAFI 1,25 LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE («LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE»).

<sup>42</sup> NENI 3, PARAGRAFI 1,2 LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Përpunimi i të dhënave personale duhet të bëhet në mënyrë të paanshme të ligjshme dhe transparente gjithnjë pa e cënuar dinjitetin e subjektit të të dhënave.<sup>43</sup> Përveç kësaj, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton si parim se përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë adekuat, relevant dhe nuk duhet të tejkalojë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje.<sup>44</sup> Po ashtu, ky ligj përcakton kufizimin se të dhënat personale mund të grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime.<sup>45</sup>

Janë disa situata e rrethana në të cilat lejohet përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme dhe atë:

“2.1. subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë për përpunimin e atyre të dhënave personale për një ose disa qëllime më specifike, përveç kur legjislacioni përkatës në fuqi përcakton që ndalimi i parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të anulohet nga subjekti i të dhënave;

2.2. përpunimi është i nevojshëm për

përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtave specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në sferën e të drejtës së punësimit, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, në masën që është i autorizuar nga legjislacioni përkatës në fuqi ose një marrëveshje kolektive që garanton të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave;

2.3. përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër fizik, nëse subjekti i të dhënave nuk është fizikisht ose ligjërisht në gjendje të japë pëlqimin;

2.4. nëse ato përpunohen për qëllime të veprimtarive legjitime dhe me garanci të duhura nga institucionet, shoqatat, asociacionet, bashkësitë fetare, sindikatat ose organizatat e tjera jofitimprurëse me qëllime politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, por vetëm nëse përpunimi ka të bëjë me anëtarët e tyre ose subjektet e të dhënave që janë në kontakt të rregullt me ato e në lidhje me qëllimet e tilla dhe nëse ata nuk i zbulojnë të dhënat e tilla të tjerëve pa pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave;

2.5. nëse subjekti i të dhënave i ka bërë ato publike pa e kufizuar përdorimin e

<sup>43</sup> NENI 4, PARAGRAFI 1, LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

<sup>44</sup> NENI 4, PARAGRAFI 3, LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

<sup>45</sup> NENI 4, PARAGRAFI 2, LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

tyre në mënyrë të dëshmuar ose të qartë;

2.6. përpunimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose kurdoherë që gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;

2.7. përpunimi është i nevojshëm për interesin thelbësor publik mbi bazën e legjislacionit përkatës; 1.8. nëse ato përpunohen në pajtim me ligjin përkatës për arsye të interesit thelbësor publik.

2.8. përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e mjekësisë parandaluese ose të punës, për vlerësimin e kapacitetit të punës së punonjësit, diagnozës mjekësore, dhënien e kujdesit shëndetësor social, trajtimin, menaxhimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor ose social dhe shërbimet mbi bazën e legjislacionit përkatës ose në pajtim me kontratat me një profesionist shëndetësor kur ato të dhëna procesohen nga ndonjë profesionist apo nën përgjegjësinë e tij që i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë profesionale sipas legjislacionit përkatës, rregullave të themeluara nga organet kompetente nacionale apo nga ndonjë person tjetër që po ashtu i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë;

2.9. përpunimi është i nevojshëm për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik, si mbrojtja ndaj kërcënimeve të rënda ndërkufitare për shëndetin ose garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor dhe të produkteve mjekësore ose pajisjeve medicinale, mbi bazën e legjislacionit përkatës; 2.10. përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e arkivimit në interes publik, të kërkimeve shkencore, historike, statistike.”<sup>46</sup>

Sidoqoftë, në rrethanat e deklaruara nga Jetoni, asnjëri nga këto kushte nuk është plotësuar, sepse:

1) Jetoni nuk e ka dhënë pëlqimin për shpërndarjen apo përpunimin e të dhënave në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore me të burgosurit e tjerë;

2) Shpërndarja e informacionit nga zyrtarët korrektues me të burgosurit e tjerë, se Jetoni pranon trajtim me metadon për shkak se është përdorues i drogave nuk ka qenë e domosdoshme për qëllim të realizimit të detyrimeve dhe të drejtave specifike të kontrol-luesit të të dhënave në fushën e punësimit në pajtim me ligjet përkatëse apo

<sup>46</sup> NENI 8, PARAGRAFI 2, LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

të ofrimit të masave mbrojtëse për të drejtat e Jetonit;

3) Shpërndarja e informacionit nga zyrtarët korrektuesme të burgosurit e tjerë në lidhje me çështje të shëndetit të Jetonit nuk ka qenë e domosdoshme për mbrojtjen e interesave jetike të tij, pasi që Jetoni ka qenë gjithnjë i aftë ligjërisht për ta dhënë apo për të mos e dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale të ndjeshme;

4) Shpërndarja e informacionit nga zyrtarët korrektuesme të burgosurit e tjerë në lidhje me gjendjen shëndetësore të Jetonit nuk është bërë për qëllime të përpunimit të të dhënave me anëtarët e asociacioneve, shoqatave, veprimtarive legjitime nga institucionet, bashkësitë fetare apo qëllime të tilla me kushtin që ata nuk i shpërndajnë këto të dhëna pa pëlqimin e Jetonit;

5) Jetoni nuk e ka bërë publik para të burgosurve të tjerë faktin se pranon trajtim me metadon për shkak se është përdorues i drogave;

6) Zyrtarët korrektues të burgut nuk janë punonjës shëndetësor ose personel shëndetësor dhe nuk e kanë shpërndarë informatën në lidhje me gjendjen shëndetësore të Jetonit me të burgosurit e tjerë me qëllim të mbro

jtjes së shëndetit të shoqërisë, individëve dhe menaxhimit ose funksionit të shërbimeve shëndetësore;

7) Shpërndarja e informacionit nga zyrtarët korrektuesme të burgosurit e tjerë në lidhje me gjendjen shëndetësore të Jetonit nuk ka qenë i nevojshëm për pohimin ose mohimin e ndonjë kërkesë ligjore;

8) Shpërndarja e informacionit nga zyrtarët korrektuesme të burgosurit e tjerë në lidhje me gjendjen shëndetësore të Jetonit nuk është bërë për arsye të interesit thelbësor publik.

Prandaj mund të përfundojmë se nuk ekziston asnjë nga përjashtimet e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtje të të Dhënave Personale i cili do të shfaqson te veprimin e supozuar të zyrtarëve korrektues të shpalosjes të të dhënave personale të ndjeshme të Jetonit me të burgosurit e tjerë në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, konkretisht në lidhje me trajtimin e tij me metadon për shkak të varësisë nga drogat.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të ndjeshme të dhënat e tilla duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe për

dorimit të paautorizuar.<sup>47</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka theksuar shumë herë rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale sidomos të të dhënave mjekësore, si çështje me rëndësi fundamentale për gëzimin e të drejtës në jetë private sipas nenit 8 të KEDNJ.<sup>48</sup> Sipas kësaj gjykate, respektimi i konfidencialitetit të të dhënave shëndetësore është parim jetik për sistemet ligjore të shteteve nënshkruese të Konventës.<sup>49</sup> Zyrtarët korrektues të burgut nuk kanë vepruar konform obligimeve të tyre për ruajtjen e të dhënave personale të ndjeshme të Jetonit dhe i kanë zbuluar pa përfillur obligimet ligjore në lidhje me mbrojtjen e privatësisë së Jetonit. Andaj mund të konsiderohet se në këtë rast ka pasur shkelje të të drejtës së privatësisë.

### **Paraqitja e ankesave për kushtet e trajtimit gjatë heqjes së lirisë**

Jetoni asnjëherë nuk ka parashtruar formalisht ankesë për kushtet e trajtimit në qendrën korrektuese ku e ka mbajtur dënimin. E drejta në ankesë

apo mbajtjes së dënimit me burgim është e garantuar dhe parashihet edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale.<sup>50</sup> Jetoni ka deklaruar se nuk është ankuar ndaj zyrtarëve korrektues për shkak të frikës se do t'i hakmerren.

Në raportin Monitorues të vitit 2016 të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura ("QKRMT"), janë evidentuar raste kur shumë nga të burgosurit kanë pasur presion psikologjik nga ana e zyrtarëve korrektues, sidomos në rastet kur të dënuarit apo të paraburgosurit janë ankuar në lidhje me trajtimin e tyre.<sup>51</sup> Po ashtu, në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë dhe në Qendrën Korrektuesenë Dubravë janë ankuar një numër i madh i të burgosurve në lidhje me zyrtarët korrektues për shkak të ofendimeve nga anëtarët e stafit korrektues.<sup>52</sup>

Mungesën e ankesave nga të burgosurit që janë përdorues të drogave për kushtet e trajtimit në qendrat korrektuese në Kosovë e ka konfirmuar edhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.<sup>53</sup>

<sup>47</sup> NENI 8, PARAGRAFI 4, LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

<sup>48</sup> L.H. KUNDËR LATVISË, GJEDNJ, NR. 52019/07, 29 KORRIK 2014, PARAGRAFI 56 DHE REFERENCAT NË TË.

<sup>49</sup> PO ATY.

<sup>50</sup> NENI 29, PARAGRAFI 6 KUSHTETUTA E KOSOVËS DHE NENI 203, PARAGRAFI 3 KPPK

<sup>51</sup> QKRMT, RAPORTI MONITORUES VJETOR, 2016, FAQE 19, PARAGRAFI 3..

<sup>52</sup> PO ATY.

<sup>53</sup> MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS, PËRGJIGJE DATËS 10 PRILL 2019, DËRGUAR PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE MË DATË 17 PRILL 2019.

Përkatësisht MKPT ka konfirmuar se asnjëherë nuk ka pranuar ankesa nga të burgosurit që janë përdorues të drogave në lidhje me trajtimin në qendrat korrektuese të cilat i kanë monitoruar.<sup>54</sup>

#### IV. E DREJTA PËR TË QENË I LIRË NGA DISKRIMINIMI

i. Jetoni i drejtohet QKUK-së dhe kërkon të shtrohet për trajtim në Klinikën e Psikiatrisë në Repartin për Sëmundjet e Varësisë. Ky Repart refuzon ta pranojë në Klinikë për shkak se Jetoni nuk ka arritur ta sjellë me vete një person të afërm apo të familjes gjatë procesit të regjistrimit.

**Këtu shtrohet çështja se a ka pasur të drejtë QKUK-ja ta refuzojë pranimin e Jetonit në Klinikën e Psikiatrisë pasi që nuk ka pasur me vete një person të afërm apo të familjes që të nënshkruajë për të?**

Për t'i verifikuar të thënat e Jetonit në lidhje me mos-pranimin në Klinikën e Psikiatrisë, Repartin për Sëmundjet e Varësisë, i jemi drejtuar këtij institucioni për të marrë informata në lidhje me

çështjet si në vijim:

1) Çfarë procedure duhet ndjekur personat për t'u shtruar për trajtim të varësisë në Klinikën e Psikiatrisë dhe çfarë dokumentesh e formularesh duhet të nënshruajnë personat që dëshirojnë të shtrohen në Klinikën e Psikiatrisë?; 2) A mund të regjistrohet në Klinikën e Psikiatrisë, Repartin e Sëmundjeve të Varësisë për trajtim si pacient personi i cili vuan nga varësia prej drogave nëse nuk ka ndonjë të afërm apo familjar që e shoqëron atë gjatë regjistrimit apo që nënshkruan për të dokumentet/formularët e regjistrimit?<sup>55</sup>

**1) Çfarë procedure duhet ndjekur personat për t'u shtruar për trajtim të varësisë në Klinikën e Psikiatrisë dhe çfarë dokumentesh e formularesh duhet të nënshruajnë personat që dëshirojnë të shtrohen në Klinikën e Psikiatrisë?**

Ushtruesja e Detyrës së Shefit të Repartit për Sëmundjet e Varësisë është përgjigjur se "Personi që pranohet në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë përpos që duhet të jetë i motivuar, duhet të jetë i shoqëruar nga një anëtar

<sup>54</sup> Po ATY.

<sup>55</sup> KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE PËR SHËRBIMIN SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS DHE KLINIKËN E PSIKIATRISË, QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS, NR.765 E DATËS 04 PRILL 2019.

i ngushtë i familjes dhe paraprakisht duhet ta nënshkruaj një formular apo kontratë me Klinikën Psikiatrisë.”<sup>56</sup> Sipas Repartit të Sëmundjeve të Varësisë, kjo kontratë duhet të respektohet me përpikmëri.<sup>57</sup> Sidoqoftë, ky institucion ka refuzuar kërkesën tonë për qasje në dokumente publike për sigurimin e kontratës dhe formularit që duhet plotësuar për t’u shtruar në Klinikën e Psikiatrisë, me arsyetimin se konsiderojnë se janë përgjigjur me korrektësi ndaj kërkesave tona për informata dhe se nuk ndihen të obliguar të japin informata tjera.<sup>58</sup>

**2) A mund të regjistrohet në Klinikën e Psikiatrisë, Repartin e Sëmundjeve të Varësisë për trajtim si pacient personi i cili vuan nga varësia prej drogave nëse nuk ka ndonjë të afërm apo familjar që e shoqëron atë gjatë regjistrimit apo që nënshkruan për të dokumentet/formularët e regjistrimit?**

Ushtruesja e Detyrës së Shefit të Repartit për Sëmundjet e Varësisë është përgjigjur se kanë pasur raste të

rralla kur i kanë pranuar personat e pa-përcjellur nga të afërmit: “në raste kur kanë qenë të vetëm, në raste kur familjarët kanë qenë jashtë vendit, ose nëse e ka pasë të sëmurë familjarin e ngushtë dhe nuk ka pas kush e zëvendëson, apo në raste ku ka qenë i domosdoshëm trajtimi (detoxin) dhe pacienti e ka pasë të domosdoshëm si kusht për rehabilitim jashtë vendit.”<sup>59</sup> Sidoqoftë, personi përgjegjës i Repartit për Sëmundjet e Varësisë e ka theksuar se “kusht për trajtim në Repartin e Varësisë është përcjellja nga familjari i ngushtë i pacientit.”<sup>60</sup>

Rrjedhimisht, ne i kemi parashtruar edhe dy pyetje shtesë për Repartin e Sëmundjeve të Varësisë për të marrë informata në lidhje me atë se çfarë procedure e ndjekin për ta pranuar personin për trajtim i cili nuk ka të afërm.<sup>61</sup> I kemi pyetur se çfarë dëshmi apo dokumente duhet të sjellë një person për të dëshmuar se nuk ka persona të afërm që mund ta shoqërojnë në Klinikën e Psikiatrisë.<sup>62</sup>

<sup>56</sup> DR. SAMIRE BRAINA, UD SHEF I REPARTIT PËR TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE TË VARËSISË, PËRGJIGJE NË KËRKESËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË DATËS 04 PRILL 2019, DËRGUAR PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE MË DATË 10 PRILL 2019.

<sup>57</sup> PO ATY.

<sup>58</sup> KLINIKA E PSIKIATRISË QKUK, PËRGJIGJE E DATËS 12 PRILL 2019 E USHTRUESËS SË DETYRËS TË SHEFIT TË REPARTIT PËR TRAJTIM SËMUNDJET E VARËSISË DR. SAMIRE BRAINA NË KËRKESËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE ME PYETJE SHITESË TË DATËS 9 PRILL 2019.

<sup>59</sup> PO ATY.

<sup>60</sup> PO ATY.

<sup>61</sup> KLINIKA E PSIKIATRISË QKUK, KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE ME PYETJE SHITESË, E DATËS 9 PRILL 2019, DREJTUAR USHTRUESËS SË DETYRËS TË SHEFIT TË REPARTIT PËR SËMUNDJET E VARËSISË, DR. SAMIRE BRAINA PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE.

<sup>62</sup> PO ATY.



Po ashtu, kemi kërkuar informata në lidhje me atë se sa persona janë pranuar në Repartin e Psikiatrisë pa shoqërim të personave të afërm.<sup>63</sup> Ushtruesja e Detyrës së Shefit të Repartit për Sëmundjet e Varësisë është përgjigjur se rastet e pranuar në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë pa përcjellës janë shumë të rralla dhe se vlerësohen “në mënyrë profesionale” nëse kanë nevojë të menjëherëshme për trajtim.<sup>64</sup> Ndërkaq, ky Repart nuk e ka bërë të ditur në numrin e saktë të personave të pranuar në Repartin e Psikiatrisë pa shoqërim të personave të afërm.<sup>65</sup>

**Çështja që shtrohet këtu është se a ka të drejtë Reparti për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë ta kushtëzojë pranimin e pacientëve që janë përdorues të drogave për t’u shtruar për detoksifikim nëse nuk kanë mundësi të jenë të shoqëruar nga persona të afërm apo familjar në momentin e regjistrimit në Klinikën e Psikiatrisë? Posaçërisht, a ka pasur të drejtë Reparti i Sëmundjeve të Varësisë ta refuzojë pranimin e Jetonit për tu shtruar për detoksifikim, për shkak se nuk ka mundur të sjellë një person të afërm nga familja?**

E drejta në trajtim të barabartë është e drejtë fundamentale njerëzore e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës. Kjo e drejtë dikton se “Të gjithë janë të barabartë para ligjit”, dhe se “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”. Bazë për diskriminim në mes tjerash është edhe gjendja shëndetësore, gjendja sociale ose personale, gjendja familjare ose martesore si dhe bazat tjera të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.<sup>66</sup>

Diskriminim sipas këtij ligji është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në cilën do bazë të përcaktuar me ligj, që ka për qëllim apo që ka për pasojë që personit t’i zhvleftësohet ose cënohet njohja, gëzimi ose ushtrimi, në mënyrë të njëjtë me të tjerët i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.<sup>67</sup> Në rastin përkatës, personii cili shkon në Klinikën e Psikiatrisë pa ndonjë të afërm gjatë procesit të regjistrimit për tu shtruar në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë, përballet me pengesa për regjistrim për

<sup>63</sup> PO ATY.

<sup>64</sup> PO ATY.

<sup>65</sup> PO ATY.

<sup>66</sup> NENI 1, PARAGRAFI 1 LIGJI NR.05/L-021 PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI («LIGJI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI»)

<sup>67</sup> NENI 3, PARAGRAFI 2 LIGJI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI.



shkak të gjendjes familjare apo personale. Cilatdo qofshin arsytet se përse personi që kërkon të shtrohet si pacient nuk ka arritur të sjellë një të afërm nga familja për ta shoqëruar gjatë regjistrimit, e drejta në trajtim mjekësor, përkatësisht e drejta për t'u shtruar në QKUK për detoksifikim i takon të gjithëve pa dallim. Kushtëzimi në baza të tilla paraqet trajtim të pabarabartë të personave në bazë të gjendjes së tyre personale dhe familjare.

Përveç kësaj, kushtëzimi i përdoruesve të drogave që të sjellin një të afërm si shoqëruar gjatë procesit të regjistrimit është problematik për shkak se konteston aftësinë e përdoruesve të drogave për të marrë vendime në kuadër të zotësisë së tyre të veprimit për t'iu nënshtruar trajtimit mjekësor. Secili person i cili e arrin moshën 18 vjeçare ose që lidhë martesë para kësaj moshe në pajtim me ligjin e fiton aftësinë e plotë për të vepruar.<sup>68</sup>

“Personit të moshës madhore që me veprimet e veta ashpërsisht i rrezikon të drejtat dhe interesat e tij ose të drejtat dhe interesat e personave të tjerë për shkak të sëmundjes psikike të diagnostifikuar, të ngecjes psikike apo

keqpërdorimit të alkoolit ose të mjeteve narkotike, të paaftësisë nga pleqëria duhet pjesërisht t'i hiqet aftësia për të vepruar”. Sidoqoftë, i vetmi organ i cili ka kompetencë për t'ia hequr zotësinë e veprimit një personi është gjykata.<sup>69</sup> Deri në momentin e nxjerrjes së vendimit nga gjykata me të cilin i hiqet ose i kufizohet zotësia e veprimit një personi, ai konsiderohet se ka zotësi të plotë të veprimit prandaj nuk mund të kushtëzohet shoqërimi i tij nga një person i afërm në një procedurë si regjistrimi për të pranuar një shërbim mjekësor nga QKUK.

Rrjedhimisht duke marrë parasysh deklaratat e Jetonit dhe informatat e siguruar nga Klinika e Psikiatrisë mund të thuhet se kushtëzimi i personave që janë përdorues të drogave të sjellin një të afërm gjatë procesit të regjistrimit për t'u shtruar për detoksifikim mund të konsiderohet si trajtim i pabarabartë dhe diskriminues në bazë të gjendjes personale dhe familjare.

ii) Një natë, Jetoni merr dozë të lartë të metadonit dhe si pasojë e kësaj i përkeqësohet shumë gjendja shëndetësore. Ai arrin në Qendrën e Emerg

<sup>68</sup> NENI 15, PARAGRAFI 3, LIGJI NR. 2004/32 PËR FAMILJEN (“LIGJI PËR FAMILJEN”).

<sup>69</sup> NENI 223, PARAGRAFI 3, LIGJI PËR FAMILJEN.

jencës në QKUK dhe kërkon ndihmë mjekësore. Personeli shëndetësor nuk pranon ta trajtojë dhe njëri nga ta i drejtohet me këto fjalë: “Pije pak ujë, flladitu. S’kena çka t’bajna na ty”.

Për përpilimin e këtij rasti studimor, përveç Jetonit i kemi intervistuar edhe tre persona tjerë që janë përdorues të drogave. Që të katërtit gjatë intervistave kanë deklaruar se i ka ndodhur që të kërkojnë ndihmë mjekësore në Shërbimin Emergjent në QKUK për shkak të problemeve serioze shëndetësore të shkaktuara nga marrja e dozës së lartë të drogave apo të përzierjes së metadonit me alkohol, dhe të katërtit kanë deklaruar se personeli mjekësor ka refuzuar t’i kontrollojë dhe t’i japë trajtim mjekësor.

Me qëllim të vërtetimit të informatave i jemi drejtuar me kërkesë për qasje në dokumente publike Shërbimit Spitalor Klinik Univeritar të Kosovës dhe Qendrës Emergjente të QKUK-së dhe i kemi pyetur se çfarë procedurash i ndjekë personeli përgjegjës i Shërbimit Emergjent kur paraqiten raste të personave të cilëve u është përkeqësuar gjendja shëndetësore për arsye të përdorimit të substancave narkotike. Posaçërisht i kemi pyetur nëse kanë protokol të veprimit për t’i trajtuar personat që shfaqen në Shërbimin Emergjent dhe

deklarojnë se kanë marrë ndonjë drogë ilegale dhe si pasojë e kësaj i është përkeqësuar gjendja shëndetësore.

Përgjigja në kërkesën për qasje në dokumente publike e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK është si vijon:

“Duke ju përgjigjur shkresës tuaj zyrtare të datës 10.04.2019/01/838 në lidhje me pyetjen të parashtruar “kur paraqiten rastet me përkeqësim të gjendjes shëndetësore për arsye të përdorimit të substancave narkotike;

- Rastet e tilla sillen nga shërbimet emergjente parahospitalore me autoambulancë në Klinikën emergjente
- Procedurat janë të njejta si për të gjithë të sëmurët
- Pranohen në dhomën e reanimacionit ku monitorohen, observohen, diagnostifikohen, kryhen analizat laboratorike dhe konsulencat specialistike
- Qëndrimi në Klinikën emergjente i këtyre të sëmurëve është 4-6 orë
- Rastet e këtilla nuk japin të dhëna në lidhje me problemet e tyre, shumica deklarojnë apo kundërshtojnë një gjë të tillë.
- Ekipet kujdestare të mjekëve emergjent në Klinikën emergjente rastet e tilla i identifikojnë përmes shenjave klinike, pas verifikimit të mbidozimit

mjeku kujdestar bën detoksifikimin dhe trajtimin e duhur barna lëngje, antidote specifike si dhe procedurat e nevojshme mjekësore.

- Çdo rast i dyshimtë informohet policia e Kosovës e cila kujdestaron 24h në Klinikën Emergjente
- Rastet e tilla kur janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe në mbështetje të avancuar të jetës, monitorohen, observohen, diagnostifikohen, kryhen analizat laboratorike dhe konsulencat specialistike pranohen në Kujdesin Intensiv, raste të tilla kemi shumë pak
- Rastet e tilla duhet të trajtohen në qendër të specializuar njësia e Toksikologjisë, që për momentin Kosova nuk e ka.
- Rastet jo me mbidozim me narkotik rrallë paraqiten në Klinikën emergjente.”<sup>70</sup>

Asnjëri nga katër të intervistuarit nuk ka paraqitur ankesë formale në QKUK për shkeljen e pretenduar të të drejtës së tyre në trajtim mjekësor. Sidoqoftë, të katër të intervistuarit janë intervistuar ndaras dhe kanë deklaruar se i ka ndodhur t’i përkeqësohet dukshëm dhe shpejtë gjendja shëndetësore për shkak të konsumimit të substancave narkotike.

Që të katër të intervistuarit kanë deklaruar se janë drejtuar në Qendrën për Shërbimin Emergjent në QKUK për trajtim dhe se personeli mjekësor ka refuzuar madje edhe t’i kontrollojë për ta përcaktuar gjendjen shëndetësore të tyre. Drejtori i Klinikës Emergjente, në përgjigjen e tij ka deklaruar se “rastet e këtilla nuk japin të dhëna në lidhje me problemet e tyre, shumica deklarojnë apo kundërshtojnë një gjë të tillë”. Në anën tjetër, Jetoni dhe tre të intervistuarit tjerë kanë deklaruar se kur janë paraqitur në Qendrën për Shërbim Emergjent në QKUK i kanë shpjeguar stafit mjekësor se çfarë e ka shkaktuar përkeqësimin e gjendjes së tyre shëndetësore (konkretisht: çfarë substancash narkotike kanë marrë dhe nëse kanë konsumuar alkohol bashkë me substancat narkotike). Disa nga të intervistuarit kanë deklaruar se pasi që i është refuzuar trajtimi mjekësor në QKUK janë detyruar të shkojnë në klinika private.

Pa e paragjykuar vërtetësinë e deklaratave të të intervistuarve, për personelin mjekësor të Qendrës për Shërbimin Emergjent duhet të jetë e qartë se e kanë për obligim t’i trajtojnë

<sup>70</sup> KLINIKA EMERGJENTE QKUK, PËRGJIGJE E DATËS 18 PRILL 2019 E DREJTORIT TË KLINIKËS DR. BASRI LENJANI NË KËRKESËN PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË DATËS 10 PRILL 2019.

të gjithë personat që kërkojnë shërbim mjekësor në mënyrë të barabartë. Bazë për diskriminim sipas Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi është edhe diskriminimi në bazë të gjendjes shëndetësore.<sup>71</sup> Në qoftë se katër të intervistuarit nuk janë pranuar as për kontroll mjekësor në Qendrën e Emergjencës së QKUK, për shkak se problemet e tyre shëndetësore kanë rrjedhur nga varësia e krijuar nga drogat, atëherë kemi të bëjmë me trajtim të pabarabartë për shkak të gjendjes shëndetësore.

---

<sup>71</sup> NENI 1, PARAGRAFI 1 LIGJIPËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI.

**PËRFUNDIME**

---

**DHE**

---

**REKOMANDIME**

---

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

---

Liria nga tortura është një ndër të drejtat e vetme absolute nga e cila nuk mund të derogohet në asnjë rrethanë.<sup>72</sup> Pretendimet e intervistuarit në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga zyrtarët policor gjatë dy përvojave të ndalimit policor, e ngrisin dyshimin se zyrtarët policor zbatojnë praktika që mund të cilësohen si torturë apo trajtim çnjerëzor, mizor ose poshtërues ndaj personave të arrestuar për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra penale që ndërlidhen me substanca narkotike. Për pretendime të torturës, GJEDNJ ka theksuar shumë herë se autoritetet shtetërore përveç obligimit për të mos përdorur torturë, trajtimi mizor, çnjerëzor e poshtërues, kanë obligim pozitiv t'i mbrojnë personat që ndodhen brenda jurisdiksionit të tyre nga nënshtrimi ndaj praktikave të tilla.<sup>73</sup> Ky obligim pozitiv i obligon shtetet që të zhvillojnë hetim ndaj çfarëdo veprimi të torturës ose trajtimit çnjerëzor, që të ndjekin penalisht personat që dyshohen se kanë kryer veprime të tilla dhe t'i ndëshkojnë sipas ligjit.<sup>74</sup> Prandaj shteti i Kosovës e ka për obligim të ndërmarrë veprime që ta parandalojë, të ndjekë penalisht dhe të ndëshkojë shkelje të tilla.

Ministria e Punëve të Brendshme do të duhej të zhvillojë një strategji të përgjithshme për parandalimin e keqtrajtimit dhe praktikave çnjerëzore e poshtëruese ndaj personave të arrestuar nga zyrtarët policor. Në anën tjetër, Inspektorati i Policisë së Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit do të duhej të zhvillonin më shumë hetime ex-officio për rastet e mundshme të zbatimit të praktikave që mund të cilësohen si torturë apo trajtim çnjerëzor nga Njësiti Policor Anti-Drogë në rastet e arrestimit të përdoruesve apo shitësve të substancave narkotike.

Shërbimi Korrektues i Kosovës që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë do të duhej të angazhohet dhe mbajë trajnime për personelin e punësuar në qendra korrektuese dhe qendra të paraburgimit për t'ia qartësuar obligimet për konfidencialitet të të dhënave personale të të burgosurve. Po ashtu, në raste të

---

<sup>72</sup> AKSOY KUNDËR TURQISË, GJEDNJ, Nr.21987/93, 1993, PARAGRAFI 62 DHE REFERNCAT NË TË.

<sup>73</sup> GJEDNJ, A KUNDËR BRITANISËSË MADHE, 23 SHTATOR 1998; GJEDNJ, Z DHETËTJERËT KUNDËR BRITANISËSË MADHE, 29392/95, 10 MAJ 2001.

<sup>74</sup> PO ATY.

zbulimit të të dhënave personale të ndjeshme të të burgosurve, sidomos sa i përket gjendjes së tyre shëndetësore, duhet të zhvillohen procedura disiplinore dhe të shqipëtohen masa të ashpra ndaj zyrtarëve korrektues për shkelje të së drejtës së privatësisë së të burgosurve në përputhje me udhëzimin administrativ në fuqi për shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore të zyrtarëve korrektues në institucionet korrektuese.

Përveç kësaj, pretendimet e personave të intervistuar në lidhje me praktikat e ndryshme të trajtimit të pabarabartë nga institucionet shëndetësore janë shumë shqetësuese sidomos duke pasë parasysh gjendjen e ndjeshme dhe nevojën për trajtim mjekësor të personave që janë përdorues të drogave. Klinika e Psikiatrisë, Reparti i Sëmundjeve të Varësisë e QKUK-së do të duhej t'i rishikojë procedurat e pranimi të pacientëve për detoksifikim ashtu që të mos trajtojnë në mënyrë të pabarabartë personat për shkak të gjendjes së tyre familjare. Përkatësisht, Klinika e Psikiatrisë duhet të heqë kushtëzimin se vetëm personat të cilët janë të shoqëruar nga personat e afërm apo të familjes mund të shtrohen si pacientë për detoksifikim në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë. Ky ndryshim do të ishte në përputhje me obligimet pozitive të shtetit për sigurimin e trajtimit të barabartë të të gjithë personave pa dallim.

Qendra e Emergjencës QKUK-së do të duhej të ndër marrë veprime për trajnimin e personelit në lidhje me trajtimin e përdoruesve të drogave gjatë procesit të pranimi pranë kësaj qendre. Pretendimet e palëve për refuzim të trajtimit mjekësor janë shumë të rënda dhe duhet adresohen me seriozitet të lartë. Një mundësi e adresimit do të ishte krijimi i protokoleve të veprimit për pranimin e personave që kërkojnë trajtim mjekësor për shkak të përdorimit të drogave. Përpos kësaj Qendra Emergjente e QKUK-së duhet të zhvillojë montorim më të kujdesshëm të trajtimit të përdoruesve të drogave nga personeli mjekësor.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Shëndetësi i Kuvendit të Kosovës do të duhej t'i thërrasë këto institucione për të raportuar dhe për të dhënë llogari para Kuvendit në lidhje me problemin e përgjithshëm të drogave në Kosovë dhe respektimin e të drejtat e njeriut të përdoruesve të drogave.

# REFERENCAT

---



## REFERENCAT

---

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Aksoy kundër Turqisë, GJEDNJ, Nr.21987/93, 1993.

Wenner kundër Gjermanisë, GJEDNJ,Nr.62303/13, 1 shtator 2016.

L.H. kundër Latvisë, GJEDNJ, Nr. 52019/07, 29 korrik 2014.

A kundërBritanisësëMadhe, GJEDNJ, 23 shtator 1998.

Z dhetëtjerkundërBritanisësëMadhe, GJEDNJ, 29392/95, 10 maj 2001.

Klinika e Psikiatrisë QKUK, Dr. Samire Braina, UD Shef i Repartit për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë, Përgjigje në Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 04 prill 2019, dërguar përmes postës elektronike më datë 10 prill 2019.

Klinika e Psikiatrisë QKUK, Përgjigje e datës 12 prill 2019 e Ushtrueses së Detyrës të Shefit të Repartit për Sëmundjet e Varësisë Dr. Samire Braina në kërkesën për qasje në dokumente publike me pyetje shtesë të datës 9 prill 2019.

Klinika e Psikiatrisë QKUK, Kërkesë për qasje në dokumente publike me pyetje shtesë, e datës 9 prill 2019, drejtuar Ushtrueses së Detyrës të Shefit të Repartit për Sëmundjet e Varësisë, Dr. Samire Braina përmes postës elektronike.

Kërkesë për qasje në dokumente publike për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe Klinikën e Psikiatrisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Nr.765 e datës 04 prill 2019.

Klinika Emergjente QKUK, Përgjigje e datës 18 prill 2019 e Drejtorit të Klinikës Dr. Basri Lenjani në kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 10 prill 2019.

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë, Përgjigje në Kërkesën për qasje në informata të datës 20 shkurt 2019, dërguar më datë 1 mars 2019.

Zyra e Komunikimit me Publikun, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Përgjigje në Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 11 prill 2019, dërguar përmes postës elektronike më datë 16 prill 2019.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Përgjigje e datës 17 prill 2019, në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike të datës 10 prill 2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit, Vendim për largimin e rastit nga lista, 29 janar 2015.

Qendra Mediko-Psikoterapike Labyrinth, Raport Statistikor, 30 janar 2019.

QKRMT, Raporti Monitorues Vjetor, 2016.

Kombet e Bashkuara, Raporti i Raportuesit Special për Torturë dhe Trajtim Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues, Juan E. Méndez, 1 shkurt 2013.

Këshilli për të Drejtat e Njeriut, Studim mbi ndikimin e problemit botëror të drogave në gëzimin e të drejtave të njeriut – Raport i Komisionier të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 4 shtator 2015.

Fatih Hafiz Mehmet. Arabia Sauditepërfundonrenovimin e burimittëujit “Zamzam” (28 mars, 2018),

<https://www.aa.com.tr/en/culture-and-art/saudi-arabia-completes-renovation-of-zamzam-well/1101268>

Saudi Geological Survey, Studimet për “Zamzam” dhe Qendra Hulumtuese,  
<https://www.sgs.org.sa/english/earth/pages/zamzam.aspx>



European  
Union  
Kosovo

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e OJQ Labyrinth dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.